A. Musa Tolaj, Nartel Center, Llam. A, H-1,
Kati 12, nr. 65-1, Prishtinë, Kosovë.
T. +383 38 600 633, +383 38 600 644
E. office@kcsfoundation.org
W. www.kcsfoundation.org

# FTESË PËR KUOTIM TË ÇMIMIT

ANKETAT ME ORGANIZATA TË SHOQËRISË CIVILE DHE HISEDARË TË JASHTËM - RISHPALLJE

NR. I REFERENCËS: 07/2022

# Përmbajtja

FTESË PËR KUOTIM TË ÇMIMIT....................6
PËRSHKRIMI I FUSHËVEPRIMIT....................7
VLERËSIMI I OFERTAVE - KRITERET E DHËNIES SË KONTRATËS....................9
SHTOJCA 1: TERMAT E REFERENCËS/PËRSHKRIMI I SHËRBIMIT....................10
SHTOJCA 2: DEKLARATA NËN BETIM NGA OPERATORËT EKONOMIK.................... 10
SHTOJCA 3: FORMULARI I PROPOZIMIT TEKNIK.................... 10
SHTOJCA 4: FORMULARI I PROPOZIMIT FINANCIAR....................10
SHTOJCA 5: UDHËZIME DHE INFORMACIONE PËR OPERATORËT EKONOMIK....................10

# FTESË PËR KUOTIM TË ÇMIMIT

Të nderuar,

I. Jeni të ftuar të paraqisni çmimin e kuotimit nëpërmjet e-mailit në adresën e dhënë në paragrafin 4, për aktivitetin e prokurimit të cekur më poshtë në përputhje me udhëzimet e bashkangjitura për operatorët ekonomik (ekspertë ose kompani).

II. Kuotimi juaj duhet të pranohet deri në ora **14:00 më 12 janar 2023** dhe do të mbetet e hapur në rast se data e fundit e lartpërmendur për dorëzimin e kuotimit të çmimit ndryshohet. Të gjitha dokumentet e paraqitura duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përshkruara në këtë ftesë të cilat përbëjnë Dosjen e Tenderit.

III. Nga ju kërkohet të plotësoni dhe të ktheni **"Shtojcën 3: Formulari i propozimit teknik & Shtojcën 4: Formulari i kuotimit të çmimit"** së bashku me të gjitha shtojcat e kërkuara tek dokumentet e tjera në përputhje me ftesën për kuotim siç janë renditur në "*Dokumentet që do të dorëzohen".*

**IV.** **Titulli i kontratës:** Anketat me organizata të shoqërisë civile dhe hisedarë të jashtëm - Rishpallje
**Numri i referencës:** 07/2022
**Data e shpalljes:** 23 dhjetor 2022
**Data e mbylljes:** 12 janar 2023
**Kohëzgjatja e kontratës:** 3 muaj
**Autoriteti kontraktues:** Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)
**Adresa:** Musa Tolaj, Lam A, H1, Kat.12, nr. 65-1, Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Kosovë
**Email Adresa për dorëzimin e ofertave *(nëse aplikohet):* *tender@kcsfoundation.org***

V. Për pyetje dhe informacione shtesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit dhe TeR ju lutem adresoni më poshtë:

E-mail: ***tender@kcsfoundation.org***
Afati i fundit për pyetje: 10 janar 2023 ora 14:00

Ju lutemi sigurohuni për të dorëzuar Ofertën në mënyrën dhe kohën e përshkruar në Udhëzimet dhe Informacionin për furnizuesit.

Me respekt,

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile

# PËRSHKRIMI I FUSHËVEPRIMIT

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Hyrja & Përmbledhja | Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) është organizatë e pavarur, jofitimprurëse, që përkrahë zhvillimin e shoqërisë civile dhe nismat që promovojnë një kulturë demokratike dhe i përgjigjen nevojave socio-ekonomike të Kosovës, me fokus të veçantë në dhënien e kontributit për procesin e integrimit në Bashkimin Europian. |
| 2 | Qëllimi i sherbimit | Qëllimi i realizimit të anketetave me organizata të shoqërisë civile dhe hisedarë të jashtëm është mbledhja e të dhënave primare në baza të rregullta për nevoja të Indeksit Kosovar për Shoqëri Civile dhe zbatimin ose dizajnimin e programeve tjera të KCSF-së. |
| 3 | Përshkrimi i shkurtër i shërbimeve të kërkuara | KCSF në këtë ftesë për koutim kërkon nga ekspertët individualë ose kompanitë (personat fizikë ose juridikë) të udhëheqë dhe realizojë punët rreth mbledhjes, organizimit dhe përpunimit të të dhënave të mbledhura në terren nëpërmjet anketimit të 101 organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, dhe 101 hisedarëve të jashtëm (që përfshijnë persona nga të gjitha sektorët dhe fushëveprimtaritë) sipas metodologjisë standarde të ofruar nga KCSF. |
| 4 | Lista dhe përshkrimi i rezultateve të pritshme që duhet të dorëzohen | Ofruesi i shërbimit / kontraktori pritet të dorëzojë shërbimin e cekur në TeR:<br>- Bazat e të dhënave të organizuara nga anketa me OShC dhe me hisedarë të jashtëm;<br>- Kopjet origjinale të pyetësorëve të plotësuar nga Anketa me OShC dhe me hisedarë të jashtëm (ose formatin e ngjashëm digjital);<br>- Listën e respondentëve të kontaktuar, të anketuar dhe që kanë refuzuar. |
| 5 | Kushtet dhe kërkesat e dërgesës | Vendi i performimit te shërbimeve është në Kosovë |
| 6 | Kohëzgjatja e pritshme e shërbimit | 3 muaj (janar-prill 2023) |
| 7 | Data e synuar për fillimin e shërbimit | 15 janar 2023 |
| 8 | Data e vlerësuar për përfundimin e shërbimit | 10 prill 2023 |
| 9 | Gjuha e propozimit | Shqip |
| 10 | Sesioni informues | Nuk aplikohet |
| 11 | Valuta e Propozimit | EUR |
| 12 | Tatimi mbi vlerën e shtuar në propozimin e çmimit | ☐ duhet të përfshijë TVSH-në dhe taksat e tjera indirekte të zbatueshme<br>☒ duhet të jetë pa TVSH por duhet të përfshijë tatimet e tjera indirekte të zbatueshme |
| 13 | Periudha e vlefshmërisë së propozimeve (Nga dita e fundit e dorëzimit të ofertave) | ☒ 60 ditë<br>☐ 90 ditë<br>☐ 120 ditë<br>Në rrethana të jashtëzakonshme, KCSF mund t'i kërkojë Tenderuesve të zgjasin vlefshmërinë e Ofertës përtej asaj që është cekur fillimisht në këtë FPK. Ofertuesit pastaj do të |

| | | |
|---|---|---|
| | | konfirmojnë zgjatje e afatit me shkrim, pa ndonjë ndryshim në Propozim. |
| 14 | Ofertimi i pjesshëm | ☒ Nuk lejohet<br>☐ Lejohet |
| 15 | Kushtet e pagesës | see table below |
| 16 | Lloji i kontratës që do të nënshkruhet | Kontratë për shërbime |
| 17 | KSCF do t'i japë kontratën: | ☒ Një dhe vetëm një Ofruesi Shërbimesh<br>☐ Një ose më shumë Ofruesve të Shërbimeve, në varësi të faktorëve të mëposhtëm: |
| 18 | Shtojcat e kësaj FPK-je | ☒ Shtojca 1: Termat e referencës / Përshkrimi i shërbimit<br>☒ Shtojca 2: Deklarata nën betim nga tenderuesi dhe parandalimi i konfliktit të interesit<br>☒ Shtojca 3: Formulari i propozimit teknik<br>☒ Shtojca 4: Formulari i propozimit financiar<br>☒ Shtojca 5: Udhëzimet dhe informacionet e përgjithshme për tenderuesit |
| 19 | Afati i fundit për dorëzimin e pyetjeve për sqarim | 10 janar 2023 |
| 20 | Dokumentet që do të dorëzohen: | ☒ Shtojca 2: Deklarata nën betim nga tenderuesi;<br>☒ Shtojca 3 & 4: Formularët e propozimit teknik dhe financiar;<br>☒ Shtojca shtesë: Certifikata e regjistrimit, numrit fiskal ose unik të biznesit (kur ofertuesi është subjekt juridik);<br>☒ Shtojca shtesë : CV-në dhe kopjen e letërnjoftimit (kur ofertuesi është subjekt fizik).<br>☒ Shtojca shtesë : Informatat për marrëveshje për sipërmarrjen e përbashkët/ konsorciumin (kur ofertuesi është konsorcium) |
| 21 | Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale | - Oferta më e favorshme (çmimi më i lirë në raport me cilësinë e kërkuar)<br>-Deklarata nën betim nga personi juridik/fizik dhe parandalimi i konfliktit të interesit<br>-Propozimi teknik<br>-Propozimi financiar |

Kushtet e pagesës (15):

| **Këste** | **Sipas rezultateve** | **Afati kohor tentativ** |
|---|---|---|
| | Fazat kryesore të anketimit, sipas marrëveshjes | Në përfundim të çdo faze |

# VLERËSIMI I OFERTAVE - KRITERET E DHËNIES SË KONTRATËS

Ndërsa çmimi është faktor i rëndësishëm, KCSF do të vlerësojë propozimet në bazë të çmimit dhe kritereve të mëposhtme:

| | | | |
|---|---|---|---|
| KRITERI 1 | **Niveli i përputhshmërisë me FPK:**<br>i. Kuptimi i të gjitha pjesëve të FPK-së (2 pikë),<br>ii. Niveli i përgjithshëm i cilësisë dhe profesionalizmit në aplikim (3 pikë) | Koeficienti | 5% |
| KRITERI 2 | **Kërkesat teknike dhe metodologjia:**<br>i. Aftësia e ofertuesit për të përmbushur kërkesat e metodologjisë (10 pikë),<br>ii. Plani i zbatimit (efektiv dhe realist) (10 pikë) | Koeficienti | 20% |
| KRITERI 3 | **Përvoja dhe kualifikimet e ekipit:**<br>i. Përvoja e përgjithshme profesionale e ekspertit/ekspërtëve/kompanisë (5 pikë),<br>ii. Përvoja relevante (10 pikë),<br>iii. Kualifikimet dhe shkathtësitë e ekspertit/ekspertëve kryesorë (5 pikë),<br>iv. Referencat (5 pikë) | Koeficienti | 25% |
| KRITERI 4 | **Propozimi Financiar:**<br>v. Çmimi më i ulët (=Çmimi më i ulët/Çmimi i propozuar*45pikë),<br>vi. Qartësia e çmimit dhe çmimi konkurrues 5pikë | Koeficienti | 50% |